

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5496
E enjte, 7 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Shqipëria e gatshme t'i jetësojë rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Kosovës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", TIME KADRIJAJ | FAQE 4-5

Mosmiratimi i platformës nuk e rrezikon vazhdimin e dialogut

- Edhe pa miratimin e platformës në Kuvend
bisedimet do të zhvillohen në nivelin e lartë



Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadriaj, ka thënë se partitë politike duhet të arrijnë konsensus për fazën finale të dialogut me Serbinë. Ajo ka theksuar se në mungesë të këtij konsensusi qeveria e ka tërhe-

qur platformën nga Kuvendi deri në një momentum më të favorshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kadriaj ka bërë me dije se platforma mund do të rikthehet në Kuvend sapo të arrihet konsensusi.

Sipas saj, platforma pastaj do të mund të plotësohet dhe të ndryshohet varësisht se si e shohin të nevojshme deputetët. Ajo ka thënë se mosmiratimi i platformës nuk e rrezikon vazhdimin e procesit të dialogut

AKTUALE

**SELMAN
PEPSHI,
PELEGRINI
I LIRISË
KOSOVARE NGA
JUNIKU NË
TROPOJË** F. 11



**VESELI ME DEPUTETË
TË POZITËS DHE TË OPOZITËS
VIZITON AUSTRIKË** F. 5

**MUJË KRASNIQI ISHTE
FRYMËZIM PËR UÇK-NË** F. 6



EKONOMI

**FMN-ja KUNDËR
KOMPENSIMIT TË
MËSIMDHËNËSVE
TË VITEVE '90** F. 9

**'VALA' MIRËPRET
BASHKATDHETARËT** F. 8

SPORT

**ARIFAJ MES OFERTAVE DHE
QËNDRIMIT TE FERONIKELI** F. 14

**SHPARTALLOHET GJILANI,
HAXHIMUSA ZGJEDH DITËN** F. 14



RAPORTUESI PËR KOSOVËN NË PARLAMENTIN EVROPIAN (PE), IGOR SOLTES, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE NË PRISHTINË

Soltesi, optimist se liberalizimi i vizave do të ndodhë në fundvit

Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE), Igor Soltes, është optimist se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë në fundvit. Gjatë qëndrimit në Kosovë ai ka thënë se në Parlamentin

Evropian ka disponim të mirë për liberalizimin e vizave për Kosovën. Soltes ka pranuar se liberalizimi i vizave është vonuar për qytetarët e Kosovës, por për këtë ai ka thënë se nuk duhet të fajësohet BE-ja | FAQE 3

Shënohen 2 201 raste të pickimit nga rriqrat

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) ka njoftuar se në periudhën shkurt - maj të këtij viti janë raportuar 2 201 raste të

pickimeve nga rriqrat në Kosovë. Numri më i madh i pickimeve nga rriqrat është nga Komuna e Malishevës, me 538 raste | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bushati: Ballkani Perëndimor, 'kopsht i lënë pas dore'

TOKIO, 6 QERSHOR - Rajoni i Ballkanit Perëndimor, "një kopsht i lënë pas dore" nga BE-ja, thotë ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati. Sërish, ministri mban një qëndrim të kujdesshëm rreth pozitës së BE-së. "Ne ende nuk kemi parë një strategji të qartë (të BE-së) se si të punojë me Ballkanin Perëndimor", tha ai, duke e quajtur rajonin një "kopsht të lënë pas dore" nga

BE-ja. Shqipëria shpreson shumë se Bashkimi Evropian të vendosë për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e vendit ish-komunist në mbledhjen e Këshillit Evropian më 28-29 qershor, për të ndihmuar çimentimin e tranzicionit të saj në ekonominë e tregut. "Ka ardhur koha që BE-ja t'i nisë negociatat me Shqipërinë për anëtarësim", tha ministri i Jashtëm Ditmir Bushati.

Në prill, Komisioni Evropian, krahu ekzekutiv i BE-së, rekomandoi që udhëheqësit e 28 vendeve anëtare të vendosin për fillimin e bisedimeve për pranimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë, bazuar në përparimin e të dy vendeve në reformat politike dhe ekonomike. Bushati nisi të dielën një vizitë treditore në Japoni për t'i promovuar marrëdhëniet dypalëshe Shqipëri - Japoni

dhe për t'u takuar me ministrin e Jashtëm Taro Kono dhe zyrtarë të Federatës Japoneze të Biznesit Keidanren. Lidhur me zgjerimin e BE-së, Bushati përshëndeti raportin e Komisionit në shkurt i cili sugjeron që vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, mund të bëhen anëtare të BE-së deri në vitin 2025. "Ne e shohim atë si një faktor motivues, për t'i përshpejtuar reformat dhe për t'i



përmbushur kushtet për anëtarësim, tha Bushati.

Delawie, i shqetësuar me incidentet kundër pjesëtarëve të komunitetit serb

Në takimin me kryeministrin Ramush Haradinaj, ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Greg Delawie, ka shprehur shqetësimin rreth numrit të incidenteve kohët e fundit të drejtuara ndaj disa individëve, disa pjesëtarëve të pakicës serbe të cilat, sipas tij, janë plotësisht të papranueshme

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Greg Delawie, ka kërkuar nga Qeveria dhe autoritetet e tjera përgjegjëse në Kosovë që t'i adresojnë në mënyrë adekuate të gjitha rastet e sulmeve ndaj pjesëtarëve të komunitetit pakicë në Kosovë. Këto komente ai i bëri për "Radion Evropa e Lirë", pas një takimi që zhvilloi me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, me ç'rast ka shprehur edhe shqetësimin e tij për rastet, siç tha ai, në rritje kohët e fundit të incidenteve në raport me pjesëtarët e komuniteteve pakicë. "Sapo pata një takim të mirë me kryeministrin, ku e trajtuam edhe këtë çështje. Sigurisht se unë ia shpreha shqetësimin tim rreth numrit të incidenteve kohët e fundit të drejtuara ndaj disa individëve, disa pjesëtarëve të

pakicës serbe. Mendoj se këto incidente janë plotësisht të papranueshme", ka theksuar Delawie. "E mirëpres deklaraten e Qeverisë të lëshuar të martën, megjithatë dëshiroj të shoh se po bëhet më shumë. Mendoj se policia qartazi po reagon në mënyrë pozitive dhe kjo është e mirë, por kjo përgjigje duhet të përmirësohet dhe që ata duhet të punojnë më shumë për parandalim e jo vetëm të merren me gjërat pasi të kenë ndodhur", ka deklaruar ambasadori amerikan, duke shtuar se Kosova është shoqëri shumetnike dhe çdokush ka përgjegjësi për të jetuar në paqe me fqinjët e tij apo të saj. "Sigurisht kërkoj që njerëzit të mos lejojnë që retorika nga qarqet e tjera t'i nxisë në sjellje negative dhe kriminale. Kjo vetëm se lëndon Kosovën, i dëmton qëllimet e Kosovës



për të ardhmen e secilit qytetar të këtij vendi", ka deklaruar ambasadori amerikan. Sipas tij, të gjithë duhet të kujdesen për sigurinë dhe qetësinë në Kosovë. "Më duhet të them se pohimet për

'terror të organizuar' apo 'ndërhyrjet e befasishme në veri' shërbejnë vetëm për t'i ngritur tensionet ndërmjet komuniteteve dhe krijojnë pasiguri më të madhe për të gjithë. Të gjitha anët - përfshirë

edhe mediat - do të duhej që me kujdes t'i masin fjalët, ta shqyrtojnë ndikimin e fjalëve të tyre dhe të bëjnë përpjekje për të kontribuar në sigurinë dhe qetësinë në Kosovë", ka deklaruar ambasadori Delawie.

Minatorët protestojnë para Kryeministrisë

TIRANË, 6 QERSHOR - Protesta dyorëshe e minatorëve shqiptarë para Kryeministrisë u mbyll me qëndrimin që të martën të nisnin grevë pa afat. Minatorët nuk kanë përjashtuar edhe hyrjen në grevë urie. Ata kërkojnë miratimin e statusit të minatorit; një draft që është hartuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjisë bashkë me grupet e interesit në 2017, por i pamiruar ende nga Qeveria, me argumentin e efekteve të mëdha financiare në buxhet.

Në propozimet e tyre kërkohet rritja e masës së pensionit në 30 mijë lekë në muaj, nga 16 mijë lekë që është ai aktual. Me prioritet, në draft konsiderohen kategoritë e dala në pension para vitit 2000. Gjithashtu, kërkohen kontrolle shëndetësore periodike falas dy herë në vit, si dhe prioritet në politikat sociale siç është e strehimit. Në protestën e tyre minatorët parashtruan disa kërkesa. Ata thonë se janë siguruar me pagë

minimale, çka pensioni i tyre nuk kalon 20 mijë lekë të reja në muaj. Përfaqësues të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë thanë se të gjithë minatorët do të jenë në grevë. "Ne do të jemi këtu derisa Qeveria të vendosë për statusin e minatorëve. Ne kërkojmë drejtësi, jo lëmoshë. Na takon për kontributin që kemi dhënë. Do të qëndrojmë para kryeministrisë pa lëvizur. Do të shkojmë deri në grevë urie", thanë drejtues të minatorëve.



Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE), Igor Soltes, ka mbajtur konferencë për medie në Prishtinë

Soltes, optimist se liberalizimi i vizave do të ndodhë në fundvit

Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE), Igor Soltes, është optimist se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë në fundvit. Gjatë qëndrimit në Kosovë ai ka thënë se në Parlamentin Evropian ka disponim të mirë për liberalizimin e vizave për Kosovën. Soltes ka pranuar se liberalizimi i vizave është vonuar për qytetarët e Kosovës, por për këtë ai ka thënë se nuk duhet të fajësohet BE-ja



është shprehur Soltes. Sipas tij, Kuvendi, Qeveria dhe të gjitha institucionet duhet të jenë transparente në vendimet e tyre, duke shtuar marrëveshjet ndërkombëtare duhet të diskutohen në Kuvendin e Kosovës. Ndër çështjet me rëndësi që kanë të bëjnë me Kosovën dhe perspektivën e saj evropiane, Soltes ka përmendur edhe dialogun me Serbinë. "Dialogu duhet të vazhdojë sa më shpejt

që të jetë e mundur dhe shpresojmë të arrihet një përfundim i suksesshëm përmes një marrëveshje të pranueshme për të dyja palët", tha ai. Gjatë kësaj vizite, eurodeputeti nga Sllovenia, Igor Soltes, ka thënë se ka diskutuar për të gjitha zhvillimet dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet Kosova aktualisht në rrugën e saj të integritimeve evropiane. Soltes ka folur edhe për dialogun për

normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka deklaruar se faza finale e këtij procesi është shumë e rëndësishme të përfundojë me një marrëveshje të pranueshme nga të dyja palët. "Ky dialog duhet të vazhdojë sa më shpejt dhe shpresoj të arrijmë një fund të suksesshëm me një marrëveshje të pranueshme për të dyja palët. Jemi shumë të vetëdijshëm se kjo është pyetje mjaft e ndjeshme, por ka rëndësi të madhe", ka thënë ai, duke shtuar se është shumë e rëndësishme për Kosovën që të gjendet një platformë për dialog të pranueshëm për pozitën dhe opozitën. Raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovën një ditë më parë është takuar me përfaqësuesit më të lartë të shtetit të Kosovës. Ai ka treguar se qëllimi i vizitës së tij në Kosovë është për të mbledhur sa më shumë të dhëna për zbatimin e agjendës evropiane të Kosovës.

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE), Igor Soltes, ka shprehur optimizëm se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të mundësohet nga fundi i këtij viti. Në një konferencë për medie mbajtur të mërkurën në Prishtinë, ai ka thënë se në Parlamentin Evropian ka disponim të mirë për liberalizimin e vizave për Kosovën. "Ne në Parlamentin Evropian jemi në favor të liberalizimit të vizave për Kosovën por, kjo varet shumë edhe nga raporti i Komisionit Evropian në lidhje me këtë çështje, i cili pritet të bëhet publik këtë muaj. Po bëjmë gjithçka që mundemi dhe presim të ketë vendime pozitive në muajt e ardhshëm. Por, nuk varet vetëm nga Parlamenti Evropian, sepse ka edhe aktorë të tjerë që kanë rolin kyç në këtë proces", ka thënë Soltes.

Ai ka rikujtuar se për të ardhur në shprehje vullneti i Parlamentit Evropian për këtë proces është i rëndësishëm rekomandimi i Komisionit Evropian, i cili pritet të jepet këtë muaj. "Jemi duke u përpjekur për përmbytjen e kërkesave tuaja dhe në muajt në vijim pritet janë të mëdha, por kjo nuk varet krejtësisht nga Parlamenti Evropian. Ka edhe aktorë të tjerë kyç që kanë për ta luajtur rol në këtë proces. Mirëpo, shpresoj se rekomandimet nga Komisioni Evropian do të jenë pozitive

dhe ky do të ishte një mesazh i rëndësishëm për dhënien e dritës së gjelbër për liberalizimin e vizave. Singlerisht shpresoj se kjo do të ndodhë deri në fund të këtij viti", është shprehur ai.

Soltes ka pranuar se liberalizimi i vizave është vonuar për qytetarët e Kosovës, por për këtë ai ka thënë se nuk duhet të fajësohet BE-ja. "Liberalizimi i vizave është vonuar, por nuk duhet fajësuar vetëm Bashkimi Evropian në këtë drejtim, ngaqë Kosova është dashur ta përmbushte këtë synim qysh para dy vjetëve bashkë me Gjeorgjinë dhe Ukrainën. Po e bëj më të mirën nga ana jonë në Parlamentin Evropian sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën", ka thënë raportuesi për Kosovën në PE. Sipas tij, qytetarët e Kosovës, sikurse edhe popujt e rajonit, meritojnë të lëvizin pa viza në Zonën Shengen. "E kuptojmë se ka pritje mjaft të mëdha nga kosovarët për liberalizimin e vizave pas ratifikimit të demarkacionit me Malin e Zi. Po ashtu, mendoj se qytetarët e Kosovës e meritojnë liberalizimin në mënyrë që edhe ata ta shijojnë të drejtën e lëvizjes pa viza", është shprehur zyrtari i lartë i PE-së.

Ndër të tjera, ai ka rikujtuar edhe shumë detyra që janë para institucioneve të Kosovës, sidomos nga fusha e sundimit të ligjit. "Para së gjithash, në lidhje me sundimin e ligjit, luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe reforma e gjyqësorit dhe pavarësinë e prokurorëve e të gjykatësve",

Bislim Zogaj zgjedhet drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur Bislim Zogajn drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. Zogaj ka arritur t'i marrë votat e 45 deputetëve. Më herët Bislim Zogaj ka qenë deputet i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Po ashtu, Zogaj ka qenë edhe i burgosur politik.



Flet për "Epokën e re", Time Kadrijaj

Mosmiratimi i platformës nuk e

- Edhe pa miratimin e platformës në Kuvend bisedimet do të zhvillohen në nivelin e lartë



Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadrijaj, ka thënë se partitë politike duhet të arrijnë konsensus për fazën finale të dialogut me Serbinë. Ajo ka theksuar se në mungesë të këtij konsensusi qeveria e ka tërhequr platformën nga Kuvendi deri në një momentum më të favorshëm. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kadrijaj ka bërë me dije se platforma mund do të rikthehet në Kuvend në momentin që të arrihet konsensusi. Sipas saj, platforma pastaj do të mund të plotësohet dhe të ndryshohet varësisht se si e shohin të nevojshme deputetët. Megjithatë, Kadrijaj ka thënë se mosmiratimi i platformës nuk e rrezikon vazhdimin e procesit të dialogut

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadrijaj, ka thënë të mërkurën se platforma shtetërore për dialog mund do të rikthehet në Kuvend sapo të arrihet konsensusi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ajo ka theksuar se kjo platformë do të mund të plotësohet dhe të ndryshohet varësisht se si e shohin të nevojshme deputetët e Kuvendit të Kosovës. "Opozita duhet të ofrojë alternativë. Duhet të bisedohet dhe të arrihet një konsensus për dialogun dhe udhëheqjen e tij. Askush nuk është kundër që edhe partitë opozitare të jenë pjesë e dialogut, nëse ato janë të gatshme të kontribuojnë në këtë proces. Nuk dua të hyj në akuza dhe kundërakuzat. Nuk pati konsensus, prandaj qeveria tërhoqi platformën deri në një momentum më të favorshëm",

ka deklaruar Kadrijaj. Megjithatë, ajo ka thënë se mosmiratimi i platformës nuk e rrezikon vazhdimin e procesit të dialogut. Sipas Kadrijajt, edhe pa miratimin e kësaj platforme bisedimet do të zhvillohen në nivelin e lartë. "Jo, nuk e rrezikon. Edhe pa miratimin e platformës në Kuvend bisedimet do të zhvillohen në nivelin e lartë. Me këtë platformë është synuar që Kuvendit t'i jepet mandat për t'i dhënë një vulë procesit të dialogut. Platforma ka qenë në vazhdimin e rritjes së transparencës së dialogut. Një prej pikave të kësaj platforme është se asnjë marrëveshje nuk duhet nënshkruar para se e njëjta të debatohet dhe miratohet në Kuvend. Do të ishte mirë ta kishim pavarësinë e plotë dhe mos të ishim të detyruar të negociojmë, por duke dashur që Kosova të ecë përpara drejt Bashkimit Evropian, të kemi liberalizim të vizave, si dhe të kemi ulëse në OKB, natyrisht se

duhet të vazhdohet procesi i dialogut, por duhet të arrihet edhe konsensusi për këtë çështje. Me apo pa arritjen e konsensusit dialogu Kosovë - Serbi duhet të përfundojë me njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve. Nëse Serbia dëshiron ta ndjekë rrugën evropiane duhet ta pranojë patjetër pavarësinë e Kosovës", është shprehur ajo. Kadrijaj ka folur edhe për themelimin e asociacionit të komunave serbe duke thënë se i njëjti do të themelohet në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

"Epoka e re": Znj. Kadrijaj, në mungesë të konsensusit Qeveria e Kosovës ka tërhequr nga shqyrtimi platformën për procesin e dialogut. Çfarë do të ndodhë tash e tutje me këtë platformë?

Kadrijaj: Platforma shtetërore për dialogun me Serbinë e hartuar nga Qeveria e Kosovës ka për synim arritjen e konsensusit politik për procesin e

rrezikon vazhdimin e dialogut

LDK-ja të ndryshojë qëndrim?

Kadrijaj: Nuk dua t'i komentoj qëndrimet e LDK-së apo të subjekteve të tjera politike. Do të punohet për t'u arritur konsensusi. Partitë politike po organizojnë tryeza për tema nacionale dhe natyrisht se edhe dialogu është një prej këtyre temave. Por, mbetet të shihet në ditët në vijim se si do ta ketë përfundimin kjo çështje.

"Epoka e re": Opozita ka kundërshtuar platformën me arsyetimin se përmbajtja e saj ka qenë e dobët dhe se presidenti nuk duhet të jetë bartës i procesit. Qëllimisht opozita dëshiron ta pengojë këtë proces?

Kadrijaj: Opozita duhet të ofrojë alternativë. Duhet të bisedohet dhe të arrihet një konsensus për dialogun dhe udhëheqjen e tij. Askush nuk është kundër që edhe partitë opozitare të jenë pjesë e dialogut, nëse ato janë të gatshme që të kontribuojnë në këtë proces. Nuk dua të hyj në akuza dhe kundërrakuza. Nuk pati konsensus, prandaj Qeveria tërhoqi platformën deri në një momentum më të favorshëm.

"Epoka e re": A mund të rikthehet platforma në Kuvend?

Kadrijaj: Platforma mund do të rikthehet në Kuvend sapo të arrihet konsensusi politik. Platforma pastaj do të mund të plotësohet dhe të ndryshohet varësisht se si e shohin të nevojshme deputetët e Kuvendit të Kosovës.

"Epoka e re": Mosmiratimi i kësaj platforme, e rrezikon vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi?

Kadrijaj: Nuk e rrezikon. Edhe pa miratimin e platformës në Kuvend bisedimet do të zhvillohen në nivelin e lartë. Me këtë platformë është synuar që Kuvendit t'i jepet mandat për t'i dhënë një vullë procesit të dialogut. Platforma ka qenë në vazhden e rritjes së transparencës së dialogut. Një prej pikave të kësaj platforme është se asnjë marrëveshje nuk duhet nënshkruar para se e njëjta të debatohet dhe miratohet në Kuvend. Do të ishte mirë që ta kishim pavarësinë e plotë dhe mos të ishim të detyruar të negociojmë, por duke dashur që Kosova të ecë përpara drejt Bashkimit Evropian, të kemi liberalizim të vizave, si dhe të kemi ulëse në OKB, natyrisht se duhet të vazhdohet procesi i dialogut, por duhet të arrihet edhe konsensusi për këtë çështje. Me apo pa arritjen e

konsensusit dialogu Kosovë - Serbi duhet të përfundojë me njohjen reciproke ndërmjet dy vendeve. Nëse Serbia dëshiron ta ndjekë rrugën evropiane duhet ta pranojë patjetër pavarësinë e Kosovës.

"Epoka e re": Si mund të prisni njohje nga Serbia e cila nuk është në gjendje t'i zbatojë as marrëveshjet për gjëra të thjeshta?

Kadrijaj: Kosova duhet të jetë më aktive në këtë proces, duke i bërë të qartë bashkësisë ndërkombëtare se po u përmbahet të gjitha marrëveshjeve, kurse Serbia nuk po i zbaton. Përmes Amerikës dhe

Gjermanisë, të cilat janë kyçur në këtë proces, duhet t'i bëhet presion Serbisë për t'i zbatuar të gjitha marrëveshjet e arritura. Ne duhet të përfaqësohemi si shtet në procesin e bisedimeve.

"Epoka e re": Znj. Kadrijaj, çfarë është duke ndodhur me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe? Do të themelohet apo jo ky asociacion?

Kadrijaj: Siç e dini, sa kemi qenë në opozitë e kemi kundërshtuar marrëveshjen për asociacionin të cilën e kemi dërguar për interpretim në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj tani, nëse do të

formohet asociacioni, do të jetë konform vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

"Epoka e re": A po i përmbush pritjet e AAK-së koalicioni qeverisës?

Kadrijaj: Qeveria ka sjellë një dinamizëm të shtuar. Kryeministri Haradinaj ka guximin për t'u përballur me çështje të mëdha dhe deri më tani ka marrë vendime të rëndësishme që e prekin qytetarin e Kosovës, kurse opozita e ka për detyrë ta bëjë punën e vet, duke mos i njohur rezultatet si dhe duke pretenduar t'i zbehë ato.

Veseli me deputetë të pozitës dhe opozitës viziton Austrinë

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga deputetë të grupeve parlamentare nga pozita dhe opozita, do të udhëtojë sot (e enjte) për vizitë zyrtare në Austri. Gjatë qëndrimit në Vjenë, kryeparlamentari Kadri Veseli do të pritë në takim të posaçëm nga kryetari i Parlamentit të Austrisë, Wolfgang Sobotka. Në takim me homologun austriak, kryeparlamentari Veseli do të diskutojë për bashkëpunimin ndër-shtetëror dhe për procesin e integriteteve evropiane të vendit, me theks të veçantë për procesin e liberalizimit të vizave. Gjatë vizitës zyrtare në Vjenë,

delegacioni i Kuvendit të Kosovës do të zhvillojë takime edhe me kryetaren e grupit parlamentar të miqësisë Austri - Kosovë, Carmen Jeitler-Cincelli, ndërsa do të pritë në një takim edhe nga Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme i Kuvendit të Austrisë si dhe takime të tjera me zyrtarë të shtetit austriak. Po gjatë kësaj vizite kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli dhe deputetët do të marrin pjesë edhe në Forumin Ekonomik Austri - Kosovë, të cilin e ka organizuar Oda Ekonomike Austriake në bashkëpunim me Ambasadën e Kosovës në Vjenë. Në këtë Forum Ekonomik, në

të cilin do të marrin pjesë qindra biznese austriake dhe ndërkombëtare, do të jenë të pranishme edhe biznese nga Kosova, ndërsa kryeparlamentari Veseli pritë të ketë një adresim ku do të flasë për potencialet që ofron Kosova dhe do t'i ftojë bizneset austriake dhe ndërkombëtare të investojnë në Kosovë. Në këtë vizitë zyrtare në Austri, kryeparlamentari Veseli do të shoqërohet nga një përfaqësues i secilit grup parlamentar: Glauk Konjufca, Aida Dërguti, Teuta Rugova, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Time Kadrijaj, Adem Hodza dhe Fikrim Damka.



dialogut. Platforma ka përfshirë pikat se si duhet të përfundojë faza finale e dialogut me Serbinë dhe se dialogu duhet të përfundojë me njohjen reciproke në mes të dy shteteve. Fillimisht kjo platformë është trajtuar në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme dhe aty është parë tendenca për kundërshtimin e saj. Platforma është dokument sikurse projektligjet dhe ka pasur mundësi që të shqyrtohet dhe debatohet në seancën plenare, pastaj grupet parlamentare t'i japin qëndrimet dhe propozimet e tyre. Duke pasur parasysh deklaratimet e grupeve parlamentare të cilat kanë hezituar për të pasur një unitet për këtë çështje, Qeveria ka tërhequr platformën nga Kuvendi deri në arritjen e një konsensusi se si duhet të organizohet faza e fundit e dialogut me Serbinë.

"Epoka e re": Sa ka gjasa që të arrihet ky konsensus? Prisni që

Mujë Krasniqi ishte frymëzim për UÇK-në



KLINË, 6 QERSHOR (ER) - "T'i këndojmë lirisë në liri. Shumë prej neve na duket e pa nevojë, por e vërteta është se heroi që na ka bashkuar sot këtu, Mujë Krasniqi, i ka kënduar lirisë edhe në robëri", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në manifestimin folklorik "I këndojmë lirisë", i 18-i me radhë, që është mbajtur në fshatin Çabiq të Komunës së Klinës, në oborrin e kullës së heroit Mujë

Krasniqi, me rastin e ditëlindjes së komandantit të UÇK-së, Mujë Krasniqi.

Kryeministri Haradinaj me këtë rast ka theksuar se sot është mirë që i këndohet lirisë dhe sillen vlera të muzikës sonë mbarëkombëtare. "Është sakrificë e vogël sot dhe sa pak jemi duke dhënë nga vetja, sepse sot i këndohet lirisë, për të cilën dikur njerëzit kanë dhënë jetën për të pasur vlerat tona kombëtare. Muzika, arti,

kultura shprehen lirshëm", ka thënë Haradinaj, duke inkurajuar talentët e muzikës të vazhdojnë tutje.

Kryeministri ka thënë se Qeveria e vendit nuk do të ndalet për ta qitur në dritë të vërtetën për rrugën deri në liri dhe për ata që kanë bërë shumë për lirinë, të vërtetën për Mujën, Aliun dhe për të gjithë dëshmorët e tjerë që kanë rënë për atdhe.

Të pranishmit për pjesëmarrje

i falënderoi Halil Krasniqi, babai i Mujë Krasniqit.

Pjesë e këtij manifestimi ishin edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, i cili tha se Mujë Krasniqi dhe Beqir Gashi, përveçse ishin luftëtarë të mëdhenj, me këngët e tyre ishin frymëzim për bashkëluftëtarë të tjerë. "Muja dhe Beqa i kënduan pareshtur lirisë. Ata sakrifkuan jetën e tyre për lirinë e vendit", ka thënë Limaj. Ai ka shtuar se

Kosova do t'i nderojë dhe do t'u jetë mirënjohës përjetë të gjithë atyre që sakrifkuan jetën e tyre për liri.

I pranishëm në këtë manifestim ishte edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, ata Malishevës, ata Klinës, deputetë, bashkëluftëtarë të Mujës dhe përfaqësues të tjerë të jetës politike e kulturore. Ky manifestim është organizuar nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Klinës.

'Isa Boletini' do t'i pranojë 1 181 studentë

MITROVICË, 6 QERSHOR (ER) - Në bazë të vendimit të Senatit, sipas propozimit të njësisë akademike, në vitin akademik 2018/19 (niveli bachelor) në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB) do të pranohen 1181 studentë. Të gjithë do të jenë studentë të rregullt, meqë në Universitetin "Isa Boletini" nuk ka studime me korrespondencë.

Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të paraparë do të regjistrohen deri në 2 për qind, përkatësisht deri në 23 studentë të rregullt që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët). Studentët e kësaj kategorie do të shpërndahen në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

Si shtesë e numrit të përgjithshëm të përcaktuar, UMIB do të regjistrojë deri në 12



për qind, përkatësisht deri 141 studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë. Kuota prej 12

përqindësh e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti joshumicë

do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të

studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

Ilir Tolaj lirohet nga të gjitha pikat e aktakuzës

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Ish-sekretari i përhershëm i Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Tolaj, është liruar nga të gjitha pikat e akuzës, në lid-

hje me shpërdorim të detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar. Avokati Besnik Berisha ka konfirmuar këtë informacion

përmes një profili në llogarinë e vet në "Facebook". "Lajm i mirë dhe i merituar për z. Ilir Tolaj dhe familjen e tij, lajm i keq për nivelin e

Prokurorisë: Lirohet nga të gjitha pikat e aktakuzës ish-sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë, prof. dr. Ilir Tolaj", ka shkruar Berisha.



Ministri Tahiri: Ndryshimi i ligjit për konfiskimin e pasurisë, i nevojshëm

**EPOKA
ERE** Faton DERMAKU

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka takuar të mërkurën përfaqësuesit e shoqërisë civile, me të cilët ka biseduar lidhur me Projektligjin e ri për kompetencat e zgjeruara në konfiskimin e pasurisë. Ministri Tahiri ka bërë me dije se ndryshimi i ligjit aktual është shtruar si nevojë pas vlerësimeve se nuk është zbatuar sa duhet, ndërkaq ndryshimet do të mundësojnë zbatim shumë më efikas të konfiskimit të pasurisë. "Politikat e konfiskimit të pasurisë së përfituar me vepër penale kanë pasur nevojë të rishikohen, në mënyrë që shteti ynë të dëshmojë se është i gatshëm për ta konfiskuar pasurinë e paligjshme si masën më reale kundër

krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe si sinjal se askush nuk mund ta shfrytëzojë pasurinë e përfituar me vepër penale", ka thënë ministri Tahiri.

Duke folur për ndryshimet themelore në projektligjin e ri, ministri Tahiri ka theksuar se janë larguar dykuptimësitë me normat e tjera të aplikueshme siç është Kodi i Procedurës Penale dhe, po ashtu, është zgjeruar lista e veprave penale për të cilat vlen nocioni i konfiskimit, përfshirë veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale të ndërlidhura me detyrën zyrtare; të atyre kundër shëndetit publik, trafikimit të njerëzve, skllavërisë dhe rrëmbimit, edhe ato që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Ministri Tahiri ka mirëpritur komentet dhe propozimet e



shoqërisë civile për këtë projektligj, të cilat do të përfshihen në procesin e mëtutjeshëm. Tahiri ka njoftuar

pjesëtarët e shoqërisë civile se Projektligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së përfituar me vepër

penale si dhe ai për mbrojtjen e sinjalizuesve do të miratohen në Qeveri në mbledhjen e ardhshme.

Shënohen 2 201 raste të pickimit nga rriqrat



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) ka njoftuar se në periudhën shkurt - maj të këtij viti janë raportuar 2 201 raste të pickimeve nga rriqrat në Kosovë. Numri më i madh i pickimeve nga rriqrat është nga Komuna e Malishevës me 538 raste

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) gjatë mbikëqyrjes permanente të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë përmes sistemit të mbikëqyrjes të situatës epidemiologjike dhe grumbullimit të rasteve për periudhën shkurt - maj 2018 ka raportuar gjithsej 2 201 raste të pickimeve nga rriqrat në Kosovë. Numri më i madh i pickimeve

nga rriqrat është nga Komuna e Malishevës me 538 raste, Suhareka me 446 raste, Klina me 249 raste, Rahoveci me 123 raste dhe komunat e tjera me numër më të vogël të rasteve. "Krahasuar me periudhën e njëjtë të viteve paraprake është raportuar numër i rritur i rasteve të pickuara. Rasti i parë pozitiv në Ethe Hemorragjike Krime Kongo në fshatin Bresalc, Komuna e Gjilanit, i

hospitalizuar në Klinikën Infektive të ShSKUK-së, është trajtuar me sukses dhe është lëshuar në shtëpi", është thënë në njoftimin e IKShP-së. Ky institut ka bërë me dije se në Departamentin e Mikrobiologjisë janë testuar gjithsej 22 mostra (nga personat e dyshimtë me Ethe Hemorragjike Krime Kongo - EHKK) të cilat kanë rezultuar negative.

Shqipëria e gatshme t'i jetësojë rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Kosovës

TIRANË, 6 QERSHOR (ER) - Deputetët e Partisë Socialdemokrate (PSD), Aida Dërguti dhe Dardan Molliqaj, së bashku me një delegacion nga Kuvendi i Kosovës, janë pritur në takim nga kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramos Ruçi, kryetari i Komisionit Parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, Eduard Shalsi, si dhe nga kryetarja e Komisionit për Sigurinë Kombëtare, Ermola Felaj.

Temë e këtyre takimeve ka qenë rezoluta për heqjen e roamingut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, rezoluta për heqjen e tërësishme të

kontrollit për hyrje-dalje e shtetasve të Republikës së Shqipërisë ndërmjet pikave të kalimit kufitare: Vërmicë, Qafë Prush dhe Qafë Morinë, si dhe rezoluta me të cilën kërkohet nga Qeveria e Kosovës t'i nisë menjëherë procedurat e nevojshme ligjore për arritjen e marrëveshjes ndërkombëtare për unifikimin e doganave me Republikën e Shqipërisë.

Institucionet e Republikës së Shqipërisë mbeten të hapura ndaj çdo kërkesë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ata i kanë konsideruar të rëndësishme rezolutat e miratuara si dhe kanë shprehur vullnetin e institucioneve të Shqipërisë për jetësimin e tyre.



'VALA' mirëpret bashkatdhetarët

EPOKA ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Telekom i Kosovës, konkretisht "VALA", edhe gjatë këtij sezoni veror mirëpret bashkatdhetarët në pikat kufitare, duke u ofruar shërbime dhe befasi të këndshme. Edhe këtë vit, sikurse në vitet paraprake, Telekom i Kosovës, "VALA", ka filluar vendosjen e pikave të shitjes (kioska) në pikat kufitare, në mënyrë që bashkatdhetarët të mund të pajisen me SIM kartela dhe mbushje, menjëherë porsa të vijnë në vendlindje.

Ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Telekomit të Kosovës, Zeqir Kiqina, gjatë takimit me disa bashkatdhetarë në pikën kufitare te Dheu i Bardhë, ka thënë se janë duke kontribuar për lehtësimin e komunikimit për diasporën. "Është një kënaqësi e veçantë të mirëpresim bashkatdhetarët tanë, të cilët në kohët më të vështira dhanë një kontribut të

jashtëzakonshëm për vendin tonë. Prandaj, kjo që po bëjmë sot është veçse një kontribut shumë modest që ka për qëllim lehtësimin e komunikimit gjatë qëndrimit të tyre në vendlindje", ka thënë Kiqina.

SIM kartelat e dedikuara për bashkatdhetarët janë më të veçanta, pasi përmbajnë afat më të gjatë vlefshmërie dhe mundësi më të leverdishme komunikimi me vendet prej nga ata vijnë. Pikat e shitjes në kufi, konkretisht te Dheu i Bardhë, Merdare dhe Vërmicë, do të jenë të hapura dhe në dispozicion të qytetarëve deri më 15 shtator 2018, kur edhe pritet që pjesa më e madhe e bashkatdhetarëve të kthehen në vendet ku jetojnë dhe punojnë. Përveç SIM kartelave për bashkatdhetarët, nëpër pikat e shitjes në kufi të gjithë konsumatorët do të kenë mundësi të blejnë numra të rinj, kartela gërvishëse e rimbushje, por edhe të marrin të gjitha informacionet e nevojshme për



pakot "Prepaid" dhe "Postpaid" të ofruara nga "VALA". Telekom i Kosovës, "VALA", si çdoherë

tjetër do të vazhdojë të jetë sa më afër bashkatdhetarëve, por edhe të gjithë konsumatorëve,

duke u përzgjedhur shërbime dhe oferta atraktive dhe shumë cilësore.



LB-ja reagon për punësimet militante në Telekom

EPOKA ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Lëvizja për Bashkim (LB) ka reaguar në lidhje me gjendjen në ndërmarrjet publike, veçanërisht për Telekomin e Kosovës. LB-ja ka vlerësuar se që nga shpallja e pavarësisë, sidomos që nga shtimi i privatizimit, ndërmarrjet

publike kanë shkuar keq e më keq. "Veçanërisht në gjendje të rëndë gjendet Telekom i Kosovës, i cili është buzë falimentimit. Qeveria e tanishme, si edhe qeveritë e mëparshme, qasjen ndaj këtij operatori të rëndësishëm ekonomik të Kosovës e ka krejtësisht të gabuar. Ajo Telekomin e shërbimeve dhe e trajton vetëm si ndërmarrje

publike që i shërben krijimit të klientelës politike e në dëm të afarizmit ekonomik. Nuk ka se si të shpjegohet ndryshe punësimi i mbi 100 militantëve partiakë, në kohën kur vetë Qeveria po thotë se kjo ndërmarrje edhe ashtu është stërnargarkuar me punëtorë dhe në kohën kur Qeveria flet për ulje të pagave në këtë ndërmarrje",

është thënë në reagimin e LB-së.

Sipas LB-së, në gjendje të njëjtë janë edhe KEK-u, Trepça, Posta dhe "Trainkos"-i. "Në të gjitha ndërmarrjet publike qasja ka qenë e njëjtë. Që nga përzgjedhja e bordeve me militantë partiakë e pa kriter profesional e deri te punësimet kryekëput familjare e partiake. Pa kurrfarë

dyshimi, kjo qasje do të çojë drejt shkatërrimit të plotë të ndërmarrjeve publike dhe pasojat ekonomike e sociale për vendin do të jenë shumë të mëdha. Ky vend, me këtë mentalitet të partive politike nuk ka të ardhme. Ky vend ka nevojë për ndryshime të thella", është thënë në reagimin e Lëvizjes për Bashkim.

FMN-ja kundër kompensimit të mësimdhënësve të viteve të '90-ta

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka përmbyllur vizitën në Kosovë të zhvilluar nga 30 maji deri më 5 qershor. Gjatë qëndrimit në Kosovë ky mision në fokus të agjendës ka pasur zhvillimet e fundit ekonomike dhe perspektivën ekonomike të Kosovës. Sipas një deklarate të lëshuar për medie, FMN-ja pret që rritja ekonomike për këtë vit të jetë në nivelin 4 për qind, derisa sektorin bankar e ka vlerësuar si të mirëkapitalizuar, likuid dhe me përfitime. Më tutje, misioni i FMN-së ka këshilluar institucionet e Kosovës që të refuzohet Projektligji për kompensimin e mësuesve të viteve të '90-ta. "Misioni këshilloi të mos vazh-

dojnë përpara me projektligjin aktual të kompensimit të mësuesve për shkak të kostove të mëdha fiskale direkte dhe indirekte, të cilat do ta rëndojnë buxhetin për shumë vjet dhe do t'ua zënë vendin shpenzimeve të tjera prioritare", është thënë në deklaratën e FMN-së.

Sa iu takon reformave për veteranët e luftës së UÇK-së, FMN-ja ka kërkuar avancimin e këtyre reformave, por ka theksuar se nuk duhet të prezantohen programe të reja me përfitime shoqërore. "Qeveria e Kosovës duhet të ketë kujdes edhe me ristrukturimin e sektorit publik për t'i minimizuar rreziqet. Misioni këshilloi që reforma në administratën publike të hartohet



mbi bazën e ligjit për kufizimin e pagave. Sa i takon sektorit privat, reformat strukturore mbështetëse duhet të për-

shpejtohen për të arritur një rritje më të fortë dhe të qëndrueshme ekonomike, ta reduktojë hendekun e pagave

me pjesën tjetër të Evropës dhe ta adresojë papunësinë e lartë", është thënë në këtë deklaratë.



Minatorët të zhgënjyer me qasjen e Bordit të 'Trepçës'

MITROVICË, 6 QERSHOR (ER) - Sindikata e Pavarur e Minatorëve të "Trepçës" i ka dërguar një letër kryeministrit Ramush Haradinaj, në të cilën ka shprehur shqetësimin lidhur me moskalimin e draftstatutit për Trepçën të propozuar nga punëtorët. Në këtë kontekst, kjo sindikatë ka paralajmëruar veprime radikale në të ardhmen, duke mos përjashtuar protestë dhe grevën e përgjithshme. "Minatorët dhe punëtorët e 'Trepçës' janë të zhgënjyer me qasjen e Bordit të

'Trepçës'. I nderuar kryeministër, nga ju është premtuar që të dy versionet e draftstatutit për 'Trepçën' të dërgohen në Kuvend, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe minatorët janë shumë të shqetësuar për këtë situatë të krijuar dhe nuk përjashtohet eskalimi i situatës ku mund të shkojë drejt protestës apo grevës së përgjithshme. Ne jemi të gatshëm që të gjitha problemet t'i zgjidhim me dialog", është thënë në letrën e Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të "Trepçës".

Investitori nga Anglia proteston para Kuvendit, kërkon drejtësi

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Fatmir Ibrahim nga Komuna e Lipjanit, i cili që 25 vjet jeton në mërgim, ka protestuar të mërkurën i vetëm para ndërtesës së Kuvendit të Kosovës lidhur me padrejtësitë që po u bëhen investuesve në Kosovë. Ai në një prononcim për gazetën "Epoka e re" ka treguar për problemet që i janë shfaqur pas blerjes së një lokali në Lipjan, ku një uzurpator nuk e ka lënë për të operuar më tutje. "Që 25 vjet jetoj në perëndim. 20 vjet kam jetuar në Angli dhe pesë vjet në Gjermani. Kam blerë një lokal në Lipjan dhe kam investuar në të, mirëpo një uzurpator nuk na ka lënë të oper-



ojmë. Unë kam marrë leje të protestoj, në mënyrë që t'ua bëj me dije institucioneve se çfarë po ndodh. Mirëpo, nëse institucionet përgjegjëse nuk bëjnë atë që duhet, drejtësinë do ta marr vetë në dorë", ka thënë Ibrahim. Po ashtu, ai ka treguar se vetëm

shefi i grupit parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka shkuar të bisedojë me të. "Vetëm Glauk Konjufca u afrua, kurse Ismet Beqiri mezi u afrua, duke e lutur të ndalet dhe të dëgjojë për çfarë jam duke protestuar", ka thënë Ibrahim.



Terreni malor në Ferizaj do të monitorohet 24 orë

FERIZAJ, 6 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, i shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë dhe Pylltarisë, Burim Bajrami, është takuar të mërkurën me komandantin e Stacionit Policor në Ferizaj, Imer Kaqara, me të cilin ka biseduar për masat që po ndërmerren kjo komunë për mbrojtje të pyjeve nga dëmtuesit, sidomos në këtë periudhë kohore. Aliu ka theksuar se qeverisja e tij është e përkushtuar për

zbatimin e politikave të mirëfillta mjedisore. "Jam i vendosur të shkoj deri në fund në betejën për mbrojtjen e pyjeve", ka thënë Aliu, duke shtuar se u pajtuan edhe me komandantin e policisë që të nisin një fushatë më rigorozë kontrolli të përbashkët për mbrojtjen e pyjeve. Ndërsa drejtori i Bujqësisë dhe Pylltarisë, Burim Bajrami, ka thënë se rajoni i Ferizajt është prekur shumë nga dëmtuesit e pyjeve.



Hoxha pritët në takim nga zyrtarët e lartë të kantonit të Gjenevës

GJAKOVË, 6 QERSHOR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate në Gjakovë, Fazli Hoxha, po qëndron për një vizitë në kantonin e Gjenevës. Hoxha është takuar me këshilltarin shtetëror për punë dhe shëndetësi të Kantonit të Gjenevës (Ministër Kantonal), Mauro Poggia, me të cilin ka

biseduar për bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës, veçanërisht kantonit të Gjenevës.

Hoxha dhe Poggia në këtë takim kanë biseduar për sektorin e shëndetësisë, ndihmën që mund ta japë kantoni i Gjenevës në të ardhmen për komunën e Gjakovës dhe në përgjithësi për

Kosovën. Hoxha ka falënderuar këshilltarin shtetëror për punë dhe shëndetësi të Kantonit të Gjenevës, Mauro Poggia, për ndihmën që shteti i Zvicrës ka dhënë dhe po jep në vazhdimësi për Kosovën. Ai ka theksuar se Kosova do ta forcojë edhe në të ardhmen bashkëpunimin me Gjenevën në shumë aspekte.



Komuna e Mitrovicës dhe Kolegji AAB nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi

MITROVICË, 6 QERSHOR (ER) - Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në pajtim me interesat e përbashkëta, Kolegji AAB dhe Komuna e Mitrovicës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi. Të dyja institucionet nëpërmjet kësaj marrëveshje të nënshkruar nga rektori i Kolegjit AAB, Lulzim Tafa

dhe kryetari i Mitrovicës, Agim Bahtiri, pajtohen që në të ardhmen të bashkëpunojnë në nisma të ndryshme për promovimin e arsimit cilësor nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta. Kjo marrëveshje bashkëpunimi përfshinë edhe kryerjen e punës praktike për studentët e Kolegjit AAB në institucionet/departamentet, drejtoritë, agjencitë,

institucionet shkollore dhe parashkollore të Komunës së Mitrovicës si dhe vizita të ndërsjella të të dy institucioneve. Kolegji AAB me këtë marrëveshje do të ofrojë bursa të plota për nxënësit më të mirë Komunës së Mitrovicës, në cilindo nga programet e studimit, si dhe pika të tjera që janë në interesin e përbashkët ndërinstitucional.

Vendos Gjykata Kushtetuese, Dardana nuk shkon në zgjedhje

PRISHTINË, 6 QERSHOR (ER) - Gjykata Kushtetuese ka hedhur poshtë kërkesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), konkretisht të ish-kandidatit të kësaj partie për kryetar të Dardanës, Shaip Surdullit, që kjo komunë të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Kësisoj kryetari i Dardanës, Qëndron Kastrati, do të vazhdojë ta Qeverisë këtë komunë deri në fund të mandatit. Në ankesën e parashtruar nga Dega e LDK-së në Dardanë thuhej se



Kastrati është zgjedhur kundërligjshëm në krye të kësaj komune. "Gjykata deklaroi kërkesën e parashtruesit të papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese", është thënë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Policia konfiskon armë në Fushë-Kosovë

FUSHË KOSOVË, 6 QERSHOR (ER) - Njësitë policore të stacionit të Fushë-Kosovës kanë konfiskuar tri armë zjarri në fshatin Bardh i Madh. "Njësitë policore të stacionit të Fushë-Kosovës kanë kryer një operacion bastisjeje në një shtëpi në fshatin Bardh i Madh, ku kanë gjetur dhe konfiskuar tri armë zjarri. Një pushkë gjuetie, një pushkë gjysmautomatike M48, një pushkë automatike AK47, si dhe 61 fishekë të llojeve dhe kalibrave të ndryshëm", është thënë në njoftimin e policisë.



Lidhur me këtë rast policia ka

arrestuar një person të dyshuar I. G., 56 vjeç, ndaj të cilit është iniciuar rasti mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. I dyshuari është intervistuar nga policia si dhe me urdhër të prokurorit të shtetit është dërguar në mbajtje.

Me rastin e 20-vjetorit të eksodit kosovar 1998-1999 nga dhuna serbo-sllave

Selman Pepshi, pelegrini i lirisë së Kosovës nga Juniku në Tropojë

Nga Gëzim PRENGZI

Tani bëhen 20 vjet nga eksodi i shqiptarëve të Kosovës, kur gjatë luftës më 1998-1999, rreth një milion shqiptarë, nga forcat paramilitare serbe, u detyruan të shpërnguleshin në Shqipëri dhe Maqedoni. Ky eksod ose dëbimi i shqiptarëve nga shtëpitë e tyre arriti kulmin pas fillimit të bombardimeve të NATO-s kundër pikave ushtarake dhe policore të ish-Jugosllavisë (Serbisë e Malit të Zi). Ashtu si në periudhat e tjera të historisë, Malësia e Gjakovës (Tropoja) mbetet streha më e ngrohtë për shqiptarët e Kosovës. Nga honet e historisë vjen kënga që shpreh mbajtjen, përkrahjen e mbrojtjen e këtyre vëllezërve nga tërbimi serbo-sllav:

*"Aferim mori Malësi
Mirë i mbajte kët muhaxherri
12 vetë ma e vogla shpi
Ma e madhja njëzet e dy
Bukën n' dorë krypën përmbi
Sa ta kem po e hamë të dy..."*

Historia u përsërit përsëri në vitet 1998-1999. Jo vetëm gjaku e afërsia gjeografike, por është "zakoni e historia". Malësia e mirë edhe në këto vite të vështira për Kosovën e kombin shqiptar u gjet si gjithmonë e pakursyer në ndihmë ndaj vëllezërve kosovarë duke çelur dyert e zemrat për ta. Janë të paharrueshme ditët e eksodit në Bajram Curri, para sheshit të Bashkisë shihje nëna që qanin për djemtë e vranë e shtëpitë që e kishin lënë.

Aty shihje banorët tropojanë që kishin dalë t'i prisnin e t'i strehonin në shtëpitë e tyre. Një solidaritet i paparë mes tropojanëve e kosovarëve, ku lindën miqësi të reja duke mbetur të pavdekshme. Personeli i spitalit të Bajram Currit ishte në gatishmëri të plotë natën e ditën në shërbim të të plagosurve kosovarë. Sakaq, më 4 qershor 2018 në Bajram Curri do të përkujtohet 20-vjetori i këtij eksodi dhe si një falënderim do të zhvillohet në Bajram Curri.

Do të ketë mjaft nga ata që u vunë në shërbim të luftës dhe e lidhën kontributin e tyre mes Kosovës e Tropojës duke u bërë njerëz të dashur e të vlerësuar për Kosovë e Malësi. E mjaft i emocionuar do të jetë njëri prej tyre, Selman Pepshi nga Juniku. Selman Pepshi u angazhua totalisht në luftën e UÇK-së si gjithë shqiptarët e Kosovës e mbarë Shqiptarisë, duke kontribuar ushtarakisht e me mjete monetare në shërbim të çlirimit e bashkimit kombëtar.

Duke qenë se lufta përfshiu jo vetëm Kosovën, por edhe Malësinë e Gjakovës e më gjerë, Selmani me rënien e Junikut vjen në Tropojë dhe ngarkohet me detyrën e regjistrimit nga Kryqi i Kuq dhe nga qytetarët e Malësisë së Gjakovës. Me përkushtimin e tij të madh u bë një mik i dashur për të gjithë të shpërngulurit nga Kosova, por edhe nga qytetarët e Tropojës tek të cilët gjeti ngrohtësinë vëllazërore duke ndarë dhimbjen së bashku, duke ndarë kafshatën e bukës së bashku.


Bazat ku përgatiteshin trupat e UÇK-së si në Babinë, Priftç, Tropojë e Koshare ishin disa nga zonat ku Selmani i dërgonte trupat dhe ndihmonte në pajisjen e tyre me armatim, ndihmoi edhe në gjetjen e të humburve dhe braktisurve nga lufta si dhe ndërmjetësimin dhe dhënien e informacionit nëpërmjet OSBE-së. Ishte i kudondodhur ku ishte nevoja e bashkëkombësve të tij që nga personeli mjekësor i spitalit Bajram Curri ku interesohej për dhënien e gjakut të plagosurve e përcjelljen për Tiranë me helikopter refugjatëve me probleme të rënda shëndetësore dhe identifikonte të vdekurit që ishin në morgun e spitalit, lidhjen me familjarët e tyre, organizimin e ceremonive të varrimit të tyre duke u bërë nderimet që ata meritonin.

Bashkëpunoi ngushtë me TV lokal të Bajram Currit, me biznesin, me pushtetin lokal dhe shoqatat e organizmat e huaja që operonin në Tropojë. Duke qenë natën dhe ditën në kontakt me luftëtarët e lirisë në bazat e përgatitjes e deri në fushën e luftës, duke bashkëpunuar me oficerët drejtues të luftës së UÇK-së u bë shkëmbyes informacionesh të vlefshme nga baza në terren.

Trokitja e tij në çdo derë malësore për hallet e popullsisë së shpërngulur e bëri Selmanin të njohur e të vlerësuar nga çdo shtëpi malësore, i cili me ndërhyrjen e tij burrërore i shpëtoi disa familje nga konfliktet e duke ndërhyrë edhe në pajtimin e disa gjaqeve.



Selman Pepshi dhuroi në shërbim të luftës mjete monetare për armatimin dhe shtëpia e tij u shndërrua një nga bazat më të forta të UÇK-së. Kampet e të shpërngulurve ishin jo vetëm në Tropojë, por edhe në rrethe të tjera. Selmani punoi shumë për ndërlidhjen e tyre që ishin ndarë, ndaj ai u lidh dhe bashkëpunoi me ekuipazhet e traqeteve "SAHILBA" e "JEZERCA" që siguronin transportin e familjarëve nga Tropoja në rrethet e tjera. Me përfundimin e luftës në Kosovë, Selmani do të jetë përsëri në shërbim të të shpërngulurve, por tani me një mision tjetër - ndihmesa për t'u rikthyer në vendin e tyre të çliruar nga zgjedha serbo-sllave. Kontributi i tij i madh për çështjen e lirisë së Kosovës është vlerësuar e çmuar nga çdo familje kosovare e tropojane. Mjaft organe të



pushtetit vendor në Tropojë e më gjerë, mjaft shoqata nga vendi e Diaspora i kanë akorduar Selman Pepshit tituj e "Mirënjohje" për kontributin e tij në Luftën Çlirimtare të Kosovës.

Selman Pepshi është nderuar me "Mirënjohje" nga Bajram Curri, Organizata e Dëshmorëve Tropojë, Organizata e Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare Tropojë, Shoqata Letrare Kulturore "Xheladin Gosturani" Tropojë, Unioni Artistik i Kombit Shqiptar dhe mjaft shoqata nga Diaspora. Këshilli Bashkiak Tropojë i ka akorduar titullin "Qytetar Nderi" i Bashkisë Tropojë.

E sot Selman Pepshi është një qytetar i lirë i Kosovës shqiptare. Do të vijë aty në Tropojë ku dha një pjesë të madhe të kontributit në shërbim të lirisë së Kosovës dhe është njeriu i dashur i çdo familje kosovare që e ndihmoi në të gjitha mënyrat. Selmani do të jetë në Tropojë si qytetari i Nderit i respektuar nga çdo burrë, grua, fëmijë e pushtetar. Sepse ai që kontribuon për lirinë e kombit do të qëndrojë gjithmonë në altarin e artë të ndërgjegjes kombëtare.

Selman Pepshit i takon medalja e artë e shqiptarizmsë, të cilën e përjeton sot në Malësinë e Gjakovës pas 20 vjetësh, por me një ndryshim: Se karafilat që u mbollën tani janë në lirinë shqiptare.



Mitrovica shënon Ditën e Dëshmorëve

MITROVICË, 6 QERSHOR (ER) - Komuna e Mitrovicës ka organizuar të mërkurën një akademi përkujtimore kushtuar 6 Qershorit, Ditës së Dëshmorëve të kësaj komune. Kryetari i kësaj komune, Agim Bahtiri, ka thënë se kjo datë është një ditë e dhimbjes, por edhe e krenarisë pasi, sipas tij, dëshmorët me gjakun e tyre shkruan historinë. "Jemi tubuar sot për të shënuar një ditë të shenjtë, të veçantë, sepse vetë këta burra që po i shihni këtu kanë qenë të veçantë. Kështu duhet atd-

heu, me zemër, shpirt dhe me sakrificë. Këta burra dhanë jetën e tyre që ne të jemi të lirë. Për hir të gjakut të tyre, por edhe të brezave të ardhshëm ne duhet të jemi të vendosur për t'i çuar proceset përpara, për ta bërë Kosovën çfarë këta e kanë dëshiruar", ka thënë Bahtiri.

Ndërsa Xhavit Jashari, kryetar i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Kosovës, ka theksuar se rrugën e bashkimit kombëtar nuk mund ta ndalojë askush pasi, sipas tij, është amanet i dësh-

morëve. Në anën tjetër, Alije Tmava, kryetare e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve në Mitrovicë, ka deklaruar se vlerat kombëtare të trashëguara nga dëshmorët janë obligim i përhershëm i të gjitha gjeneratave të ardhshme. Në nderim të dëshmorëve, përfaqësues të institucioneve, FSK-së, policisë, organizatave të dala nga lufta, familjarë, si dhe shumë qytetarë, të mërkurën kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora me lule në varezat e dëshmorëve në Shipol.



Filialet e shërbimeve sekrete jugosllave në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame (2)

- Hoxhallarët komunistë marksistë-leninistë jugosllavë dhe nacionalistët shqiptarë



Bardhyl MAHMUTI

Çuditërisht, në të gjitha organet e BFI-së kam hasur në kolegë e hoxhallarë që ma përkrahnin programin, askush nuk e thoshte më të voglën fjalë. Bashkë futeshim nëpër xhami, ku xhami i hapte sytë katër kurse, unë shpërtheja vrullshëm kundër të gjithë atyre aventurierëve që po ëndërronin për prishjen e Jugosllavisë. Nuk kishte bërë vaki më herët që nëpër xhami të dëgjoheshin duartrokitjet frenetike të xhematit. Në fund të ligjëratave, sikur ishte bërë traditë që tashmë të bërtisnin "Ju-go-sllavia, ju-go-sllavia... Sulo, Sulo..." Edhe pse nuk e kishin atë motivacion të thirrjeve "zharko... zharko", me të cilat shpërthente Kiro Fuzofski kur më dëgjonte, megjithatë, edhe thirrjet "Sulo... Sulo", seç më bënin krenar dhe të pathyeshëm në rrugën e Titos.

Natyrisht, përveç revoles, me vete merrja edhe një shumë të konsiderueshme të dinarëve që m'i jepte me bollëk Kiroja, sepse hasja në shumë xhemat që kishin probleme të rënda sociale. Dhënia e një dinari e shtonte dhënien për Jugosllavinë. Natyrisht, një dinar atyre e dhjetë për veta. Nuk kishte nevojë të raportoj se kah shkonin ato dinarë, me rëndësi të më shihnin dikush se po ndaj pare, sepse e dija që në mesin e xhematëve kishte plotë spiunë që po e përcillnin punën time dhe që raportonin edhe te Kiro Fuzofski. Parja ta zbardhë fytyrën. Kur nuk e ke paranë e ke urrejtjen e Zotit... (Memoari nr. 32) pohon kryetari i BFI-së së Maqedonisë, Sulejman Rexhepi.

"Tani, kur e kujtoj babain tim, menjëherë më bëhet e qartë se pse aq shumë insistonte që të ikja diku në tokat arabe për të kryer edhe ndonjë fakultet teologjik. Nuk donte që të përfundoja në Sarajevë. Donte në shtetet arabe. Po pra, sepse vetëm në ato shtete mund të më spastrohej truri nga ai infektim nacionalist që më ishte bërë gjatë shkollimit të mesëm në Kosovë. Iu binda tepër shumë babait, aq shumë sa nga memoria ime kam fshirë të gjithë ata shokë, të gjithë ata njerëz e personalitete me të cilët kundenim shqiptarçe dhe me tone mjaft nacionaliste. I pata fshirë si dashakëqij të karrierës sime dhe, tek pastaj u brumosa me kulturë dhe njohuri islamo-arabe". (Memoari nr. 1)

"Kujtimet vijnë me përgatitjen për të shkuar në studime ku duhej "ta spastronte trurin nga infektimi me nacionalizëm shqiptar". Në Memoarin nr. 6 të emëruar "Vëllazërim-Bashkimi më i suksesshëm se Islami" Sulejman Rexhepi shkruan: "ditën kur e preva biletën për në Beograd, prej nga do të fluturoja për në Kuvajt, pas katundarit tim, topallit, më kishte dërguar fjalë Goran Subashiq, i cili në takimin tonë në një zyre të këshillit ekzekutiv të qytetit të Shkupit, m'u prezantua si rreshter i vjetër, përgjegjës i sektorit për çështjet fetare pranë KOS-it. (Akronim serb për Shërbimin e Kundërzbulimit jugosllav - sqarim BM).

Pasi u bind se unë me tërë shpirt isha jugosllav i zjarrtë, më porosi që të imazh ta përcillja kudo që do të shkoja, sepse, kështu do të dilja i nderuar atje por edhe brenda. Më tha që, në çdo fakultet ku shkojnë studentët tanë nëpër shtetet arabe, kanë për detyrë të përcjellin njëri tjetrin dhe këtë nuk e dinë asnjëri. Të gjithë kur të kthehen në vendlindjen e tyre, do të raportojnë për njëri tjetrin, prandaj, më tha, hap sytë dhe, më mirë të raportosh ti për shokët se sa shokët të raportojnë për ty. Jugosllavia nuk ka vend për ata teologë që nuk do të jenë markë jugosllave. 'Kujdes, më tha, shtetet arabe janë në anën tonë, prandaj, as mos tentoni që të futeni nëpër lëvizjet ekstremiste që tentojnë t'i destabilizojnë shtetet mike arabe. Prandaj, do t'i vëzhgosh këta ujçer, mundësisht edhe t'i eliminosh nga pozicioni i gjyqtarit, më tha si në shaka e që, duke më shtrenguar damarin e qafës desh më paralizoi në vend. Në ty e shohim të ringjallur Gjorçe Petrovin tonë, më tha pasi më uroi udhë të mbarë për në Kuvajt

Që nga ai moment, të gjithë që më provokonin, qofshin ata edhe miqtë e mi më të ngushtë, menjëherë krijoja përshtypje se i ka lëshuar Subashiqi, të më përcjellin, prandaj në të tilla situatë reagoja i papërmbytur. Prandaj i reagoja aq ashpër edhe profesorit arab, el Shuajbit, i cili, për një moment, seç m'u duk si mik i rreshterit të vjetër, Goran Subashiqit, të cilit më duhej t'i raportoja sa herë që kthehesha në Shkup por, jo rallë i raportoja edhe përmes njerëzve "diplomatikë" që më takonin sa herë që donin të iknin nga Kuvajti. "Suljo, mos ke ndonjë selam për Subashiqin", më thoshin fare pa m'u prezantuar. Sapo ma përmendnin emrin e tij, e dija që janë të lozes së tij. Nuk ishte edhe aq lehtë të bëheshe teolog në

shtetet mike të Jugosllavisë. Ne duhej të ishim shembull i Jugosllavisë së vëllazërim-bashkimit, shembull këtë që nuk po mund ta arrinte madje as islami si fe! Edhe këtë, falë atij rrjeti të spiunëve që ishte i shtrirë cep më cep botës". (Memoari nr. 6) Sulejman Rexhepi evokon kujtimet kur ishte konfrontuar me profesorët në Kuvajt në mbrojtje të komunizmit jugosllav, si i kishte denoncuar te përfaqësuesit diplomatikë të Jugosllavisë në këtë shtet... "Vitin e parë, kur u kthyem nga Kuvajti, menjëherë pas njerëzve të familjes së ngushtë, më takoi rreshteri i vjetër, Subashiqi. Më pyeti për disa gjëra për të cilat nuk i dite askush përveç se meje dhe shokut tim të ngushtë, Zulhajratit. Në atë çast u pata betuar se do ta djeg këtë njeri. 'Mos më thënshin Sulë nëse nuk e përvëlloj si me prush Zulhajratin!' - ishte betuar Sulejman Rexhepi (Memoari nr. 7).

Këtë betim e realizoi që në raportin e parë me shkrim që i bëri UDB-së. "Kur Subashiqi mi tregoi disa gjëra të cilat i dinte vetëm shoku im Zulhajrati vendosa që edhe unë të tregoja diçka që dija për të. Më tha që, historia nuk bëhet duke folur por duke lënë gjurmë me shkrim. Më dha një copë letër dhe një laps kimik e më tha: "shkrualj"! Seç m'u duk si urdhri "ikre"! (Memoari nr. 8)

Për ata që nuk e dinë, fjala "ikre", që varësisht nga përkthimet e ndryshme, ka kuptimin e fjalëve "lexo", "shkrualj", "këndo" (në kuptimin "recito") është porosi e Allahut, të cilën, sipas besimit islam, engjëlli me emrin Xhibril ia tha Muhamedit kur filloi t'i zbriste Kuranin. Përmendja e kësaj fjale nga ana e një teologu në kontekstin e relacioneve brenda Shërbimit Sekret të Kundërzbulimit të Jugosllavisë, tregon se si i ka konsideruar Sulejman Rexhepi urdhrat e UDB-së: si urdhra të Allahut! Memoari nr. 8 e përfundon me raportin e parë me shkrim, që ky teolog kishte bërë për "shokun" e vet: "Mezi i shkrova në qirilicë nja dy-tre elemente për Zulhajratin: 1. Zuli (kështu i thoshte Subo shokut tim Zulhajratit) i urrente tmerrësisht arabët, të cilët asgjë nuk dinin për shqiptarët, ndërsa për jugosllavët e për Titon ishin në gjendje të hiqnin dorë edhe prej fesë islame...".

Sulejman Rexhepi, ky teolog që deklaroi publikisht se me tërë shpirt ishte "jugosllav i zjarrtë" dhe "komunist", lëshohet në krahasimin me nacionalistët shqiptarë, që e donin Enver Hoxhën në raport me Titon.

Ai shtron pyetjen me një pikëçu-

ditje në fund: "A mund të ishin enveristët (ithtarët e Enver Hoxhës) më shqiptarë se unë! Ata, adhuruesit e këtij satrapi, të ishin më nacionalistë se unë nuk ndodh në asnjë mënyrë! Ai njeri që nuk e do fenë e popullit të vet ai nuk e do as vetë popullin. Prandaj, këtë tip nacionalistësh i urreja. Ata marksista-leninista, unë marksist-leninist! Ata e donin Shqipërinë, unë e doja Shqipërinë. Ata dëgjonin këngë folklorike e patriotike, po ashtu edhe unë i dëgjoja. I vetmi dallim ishte se unë nuk e doja Enverin, liderin shpirtëror të tyre. Nuk mund të paramendoja kombin shqiptar pa fe! Më dukej gjë e tmerrshme. Prandaj, qysh në Prishtinë, si nxënës i Medresesë, u pata rreshtuar në anën e atyre që i luftonin këta qafira, këta të pafe. Kishim shkuar aq larg sa e kishim bërë hallall bashkëpunimin me policinë jugosllave kundër këtyre enveristave". (Memoari nr. 8)

"Kurë nuk arrita ta kuptoj se prej nga buronte tek unë tërë ajo energji negative kundër shqiptarëve irredentistë e separatistë. Po si nuk patën më të voglin insaf për Jugosllavinë. Të gjitha indikacionet e shërbimeve sekrete flisnin se ata i kishin hyrë punës për ta rrënuar Jugosllavinë, për të cilën baballarët tanë kishin derdhur aq djersë e gjak. Të gjithë që i kontaktoja, me të gjithë që e kaloja ditën dhe natën, ma mbushnin mendjen se me mijëra herë më shumë kishte shqiptarë që e donin Jugosllavinë në krahasim me irredentistët. Kjo ma shtonte urrejtjen deri në zhdukje të tyre. Kjo m'i arsyetonte të gjitha mjetet dhe metodat që i përdorja në luftë kundër këtij irredentizmi e separatizmi. Nuk besoj të kenë fshehur nga unë ndonjë qëndrim, sepse, të gjithë ishim të sinqertë, të gjithë angazhoheshim për ruajtjen e shtetit të përbashkët të vëllazërim-bashkimit tonë. Se nga dolën pastaj të jenë të gjithë shqiptarët e mundshëm për Kosovën Republikë dhe për Shqipërinë e Madhe këtë kurrë nuk arrita ta kuptoj.

Menjëherë pas demonstratave të para në Kosovë, po ndjeheshin lëvizje edhe në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë, të cilët po ngacmoheshin sidomos nga studentët e kësaj ane që po studionin në Prishtinë. Dy persona u përzgjodhën dhe na i ndanë detyrat të cilat duhej kryer me besnikëri, me devotshmëri dhe me përkushtim. Unë u angazhova që të ndikoja tek shtesa e teologëve por edhe ta kontrolloja këtë komunitet, ndërsa profesor Sefedin Sulejmani u angazhua të ndikonte dhe të ushtronte kontroll mbi stafin akademik dhe mbi studentët shqiptarë të kësaj

ane. Profesori Sefedin e pati më të lehtë, sepse edhe ishte i gojës por edhe i kalemit. Dinte të shprehje por edhe të shkruante. Në vitet '80 ai tashmë kishte mbi 50 vepra të shkruara, nga sfera e filozofisë dhe marksizmit, ndërsa unë isha tamam tokmak! Çuditërisht nisën të botohen deklarata të mia por edhe shkrime në emrin tim. Çfarë gëzimi i papërshtetshëm kur gjeja ndonjë shkrim të botuar me emrin tim. E merrja gazetën, e fusja nën sjetull dhe i bija poshtë e lartë rrugëve të Bit Pazarit. Nisa të shikohem si një person mjaft atraktiv, vizionar dhe marksist i përkushtuar. Edhe hoxhë edhe marksist - kjo e bënte madhështor qëndrimin tim prej komunisti të përkushtuar. Më vitin 1983, në Takvimin e BFI-së që e përgatiste për botim Shoqata 'Ilmije', e cila historikisht më tepër ka qenë organ i Lidhjes Komuniste se sa i BFI-së, botova shkrimin tim mbi irredentizmin dhe separatizmin shqiptar si dhe për përcaktimet imediate të të gjithë teologëve në rreshtimin e tyre për kalitjen e mëtejme të vëllazërim-bashkimit jugosllav. Vetëm ky shkrim u mbajt mend nga ana e shqiptarëve, kurse unë kisha botuar edhe dhjetra të tjerë që po botoheshin nëpër biltenet policore dhe ushtarake nëpër republikat e vendit dhe zonat ushtarake të Jugosllavisë". Memoari nr. 35

Për shkak të besnikërisë dhe provave që kishte treguar, se me tërë shpirt ishte "jugosllav i zjarrtë" dhe "hoxhë komunist", Sulejman Rexhepi filloi të ngjitej në grada: iu dhanë edhe informatorë të tjerë, që do t'i përcillnin spiunimet e tyre përmes tij.

"Kiro Fozufski, inspektori më i përgatitur në radhët e UDB-së për përndjekjen e separatistëve dhe irredentistëve shqiptarë, tashmë kishte krijuar një besim të fuqishëm në mua. Po ndjehej i habitur por edhe pak i lodhur nga gatishmëria e aq shumë shqiptarëve për të raportuar vullnetarisht tek ai. Një herë ma shprehu dëshimin, duke menduar se, mos irredentistët shqiptarë po dilnin më të aftë se UDB-a dhe se qëllimisht po u dërgonin sa më shumë shqiptarë të raportojnë, me qëllim që t'ua tolovisin trutë! Prandaj, më luti që t'ia eliminoja nja dy si më të besdishëm, dy shqiptarë që natë e ditë ishin në gjendje t'ia mbajnë bolet në duar. Njëri ishte nga Kondova, me nofken 'Teglla', për shkak të xhamit të syzave të tij që dukeshin si fundi i kaVanozit (Zejnullah Fazliu), e tjetri ishte nga Morana, me nofken 'Mandolina', sepse kur e raportonte ndonjë informatë e nxirrte si tingujt e telave të çakorduara të mandolinës (Azem Morana)! (Vijon)

E rrallë

Policët gjejnë të arratisurin të fshehur nëntokë

Jean Gomes Chiola nga Brazili ishte në kërkim nga policia që tre vjet. Policia kapi të arratisurin pasi mori një telefonatë anonime që tregonte se Chiola ishte fshehur në një pronë në Macaiba. Ai ishte fshehur në një bunker nëntokësor.



FOTO E DITES



Në Austri u organizua gara me motoçikleta. /AFP/

E jashtëzakonshme

Kamerieri kthehet në 'hero', ua shpëton jetën dy policëve

Një kamerier në Londër ua ka shpëtuar jetën dy policëve që kishin mbetur të bllokuar brenda veturës e cila ishte përmbysur në një anë. Riyad El-Hassani, 24-vjeç, nxori shëndoshë e mirë policët që ishin rrokullisur me



makinën në Limehouse në pjesën lindore të Londrës.

BARSOLETA E DITËS



Një djalosh shumë i varfër i dhuron të fejuarës, ditën e përvjetorit, një kuti bosh dhe i thotë: "E dashur, të uroj të kesh imagjinatë shumë të pasur!"



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Jo të gjitha objektivat tuaja do të realizohen sot. Shumë dyshime lidhur me një marrëveshje të bërë në çastet e fundit.



DEMI

Sot mund t'i mbron shumë mirë idetë tuaja edhe pa e ngritur tonin e zërit. Në shumë raste kjo gjë vetëm do t'ju dëmtojë duke krijuar mosbesim.



BINJAKËT

Do të ketë një harmoni midis gjithë personave tuaj të afërt sot falë inteligjencës tuaj që keni ditur se si t'i sheshoni mosmarrëveshjet.



GAFORRJA

Sot do të keni debate me këdo që del përpara në rrugën tuaj. Jo gjithmonë ata që mendojnë ndryshe nga ju e kanë gabim, mbase po gaboni ju.



LUANI

Një udhëtim i papritur do t'i ndryshojë të gjitha planet e ditës suaj. Duhet të shtyni për më vonë çdo gjë që kishit menduar të bënit.



VI RGJËR ESHA

Sot ju duhet të merreni me financat që po fillojnë po zvogëlohen shumë kohët e fundit. Filloni të kurseni pak që të ndiheni më të qetë.



PESHORJA

Vazhdoni të jeni të sjellë pavendosur në qëndrimet që merrni. Kjo do të sjellë konfuzion jo vetëm tek ju, por edhe te personat që varen nga ju.



AKREPI

Sot do të merrni një dhuratë që nuk e prisnit. Çdo gjë e mirë që po ju ndodh është falë sjelljes suaj korrekte me këdo që ju ka lidhur puna.



SHIGJETARI

Keni një takim që mezi po e prisni dhe po i kushtoni të gjithë vëmendjen tuaj. Në saje të tij varen shumë gjëra në të ardhmen tuaj.



BRICJAPI

Jeni duke ecur në rrugë të ndryshme me partnerin dhe kjo gjë do t'ju nervozojë shumë sot. Do të shkoni drejt një ftohje që sa vjen po bëhet më e thellë.



UJORI

Do të dëgjoni lajme të bukura nga miqtë tuaj sot dhe kjo gjë do t'ju kënaqë pa masë. Mbase edhe ju mund të bëheni protagonist duke dhënë një lajm tuajin.



PESHQIT

Nëse ndryshoni ambient e keni të qartë se ku doni të shkoni. Jeni të dashuruar me detin dhe është vendi juaj ideal për t'u relaksuar.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ENGLAND - COSTA RICA

1

PORTUGAL - ALGERIA

1

ICELAND - GHANA

1

Arifaj, mes ofertave dhe qëndrimit te Feronikeli

Brenda dy ditësh do të vendoset e ardhmja e sulmuesit Granit Arifaj. Sulmuesi ka marrë ofertë edhe nga Besa e Pejës, por nuk e mohon mundësinë e qëndrimit në "Nikel". "Ende zyrtarisht nuk jam larguar nga Feronikeli. Deri në fund të kësaj jave do të vendoset gjithçka, por ekziston mundësia të mos largohem. Nëse gjejmë gjuhë të përbashkët me drejtuesit e klubit, pa problem mund të mbes pjesë e klubit aktual", ka thënë Granit Arifaj



edicionin e fundit në skuadrën e Feronikelit, Mark Milicaj, Qemail Elshani, Albert Dabiqaj dhe Behar Maliqi.

Gjeraj, i pavendosur për të ardhmen

Një nga lojtarët me përvojën më të madhe në futbollin e

Kosovës, Robert Gjeraj, ende nuk ka vendosur për të ardhmen e tij. Kontrata e mbrojtësit që iu bashkua në janar skuadrës pejane ka përfunduar. Gjeraj, i kontaktuar nga "Epoka e re", ka thënë se ende nuk ka diçka rreth të ardhmes së tij, por ka bërë me dije se klubi i ri do të mësohet së shpejti.

thënë Arifaj. Gjatë ditëve të fundit në adresë të Arifajt nuk kanë munguar ofertat nga klubet e Vala Superligës dhe Ligës së Parë. Sulmuesi shtatlartë nuk hezitoi të tregojë për kontaktet me Besën e Pejës, e cila do të bëjë gara në Ligën e Parë. "Ofertë kam nga Besa dhe ende jemi në bisedime, por diçka konkrete nuk ka. Edhe dy klube të tjera më kanë kontaktuar, por emrat e tyre tash për tash nuk kisha dashur t'i bëjë publik", ka deklaruar ai. Granit Arifaj në rast se transferohet te Besa do të punojë sërish me ish-trajnerin Ismet Munishi. Ashtu sikurse e ardhmja e Arifajt, ende nuk dihet përfundimisht as e ardhmja e lojtarëve kryesorë në

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Pavarësisht se është raportuar shumë nëpër medie se Granit Arifaj nuk bën pjesë në planet e Feronikelit për edicionin 2018/2019, futbollisti në fjalë të mërkurën për "Epokën e re" ka thënë se ende zyrtarisht është pjesë e kësaj skuadre dhe se ka gjasa të mbetet sërish pjesë e saj. "Ende zyrtarisht nuk jam larguar nga Feronikeli. Deri në fund të kësaj jave do të vendoset gjithçka, por ekziston mundësia të mos largohem. Nëse gjejmë gjuhë të përbashkët me drejtuesit e klubit, pa ndonjë problem mund të mbes pjesë e klubit aktual", ka

SHKURT

Donja Sadiku sot përballet me Aneta Ryfielskan

Boksieria më e mirë e Kosovës, Donjeta Sadiku, e ka mësuar emrin e kundërshtares me të cilën do të përballet në Kampionatin Evropian të Boksit, i cili ka filluar të martën në Sofje të Bullgarisë. Sadiku rrethin e parë e ka kaluar pa luftë, ndërsa në atë të dytë do të ketë punë me polaken Aneta Ryfielska, e cila kaloi në këtë rreth pa luftë. Përballja mes këtyre dy boksierëve do të zhvillohet sot (e enjte), kurse Donjeta Sadiku po synon fitore ndaj polakes, e cila ka shumë përvojë në kategorinë e senioreve.

Liburni transferoi Alibegun dhe Gashin

Skuadra e Liburnit ka transferuar Narcis Alibegun dhe Kemajl Gashin, të cilët në edicionin e fundit u shpallën kampionë në Shqipëri me skuadrën e Tiranës. Ish-lojtarët e Feniksit dhe, së fundi, të Tiranës, me të cilën u shpallën kampionë në Shqipëri, Narcis Alibegu dhe Kemajl Gashi, e kanë përforcuar Liburnin për edicionin 2018/2019. Liburni për sezonin e ri do të jetë me një pasqyrë tjetër dhe me këto përforcime do të jetë pretendenti kryesor për titull.

Nikaj, trajner i Vushtrisë

FC Vushtrria ka arritur marrëveshje me trajnerin Samuel Nikaj. Nikaj është nga qyteti i Shkodrës dhe ka një bagazh të madh të rikthimeve të skuadrave në rangjet elitare. Nikaj i ka rikthyer nga Liga e Parë në Superligë: KF Flamurtarin (Prishtinë) dhe KS Kastriotin (Krujë) në Shqipëri. Ai më herët ka drejtuar edhe skuadrat si KF Vllaznia (Shkodër) dhe KF Besëlidhja (Lezhë). Me Nikajn trajner, FC Vushtrria synon Superligën në sezonin e ardhshëm.

Shpartallohet Gjilani, Haxhimusa zgjedh Dritën

Betim Haxhimusa, Edmond Turku dhe Isa Eminhaziri janë larguar edhe zyrtarisht të mërkurën nga skuadra e Gjilanit, e cila po përjeton një valë të madhe largimesh. Haxhimusa ka nënshkruar menjëherë për Dritën, kurse dy futbollistët e tjerë, Turku dhe Eminhaziri, janë lojtarë të lirë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Skuadra e Gjilanit është duke shkuar drejt një shpartallimi total, pasi shumica e lojtarëve të kësaj skuadre janë larguar dhe disa të tjerë pritet të largohen. Fillimisht nga kjo skuadër është larguar reprezentuesi i Kosovës, Armend Thaqi, që vendos për një rikthim të madh te Prishtina, kurse skuadrën kryeqytetase e zgjodhi edhe mbrojtësi me përvojë të madhe, Leotrim Beketeshi. Të mërkurën një goditje të madhe skuadrës së Gjilanit dhe tifozëve "Skifterave" ua ka dhënë Betim Haxhimusa, i cili vendosi ta zgjedhë rivalen e madhe të Gjilanit, Dritën.

Haxhimusa u prezantua te skuadra kampione, e cila nëpërmjet një njoftimi ka bërë me dije se ky futbollist ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2021 dhe me të Drita do të jetë edhe më e fortë në repartin e sulmit. Gjilanin të mërkurën e braktisi edhe mbrojtësi i shquar Edmond Turku. Ish-anëtari i Besës dhe Trepçës '89 nuk ka dashur të tregojë për skuadrën e re, por vetëm konfirmoi largimin. "KF Gjilani i dëshiroj suksese në të ardhmen. Falënderoj të gjithë ata me të cilët pata rastin të bashkëpunoj, gjithashtu kryesinë e klubit për korrektësinë", ka thënë Turku. Njëjtë sikur Turku ka vepruar edhe Isa Eminhaziri, i cili ka falënderuar skuadrën e Gjilanit, "Skifterat", kryesinë e klubit,



bashkëlojtarët dhe trajnerët. "Faleminderit Gjilan për kohën e kaluar së bashku dhe suksese në vazhdimësi! Më nuk do të jem pjesë e kësaj skuadre", ka

thënë ish-lojtari i Feronikelit. Lojtarët e tjerë që pritet të largohen së shpejti nga Gjilani janë: Fisnik Papuçi, Arbër Shala dhe Hasan Hyseni.

Khaka: Ndaj Serbisë do të vdesim për fitoren

CYRIL, 6 QERSHOR - Ndeshja midis Zvicrës dhe Serbisë do të luhet në Kaliningrad më 22 qershor dhe do të ketë rëndësi të madhe edhe për disa futbollistë shqiptarë. Në fakt, te zvicranët do të

luajnë disa lojtarë që prindërit i kanë nga Kosova, e cila ishte në luftë me shtetin serb. Granit Xhaka, ylli i Arsenalit, prindërit e të cilit erdhën në Bazël nga Kosova, ka thënë se do të luajë

deri në kufirin e dhimbjes. "Serbia është një kundërshtarë e pakëndshme. Në këtë moment nuk mund të premtoj asgjë përveçse do të luajmë deri në kufi të dhimbjeve ekstreme. Do

të vdesim për fitoren", ka pohuar Xhaka, shkruan "index.hr". Përveç Xhakës, edhe prindërit e Xherdan Shaqirit dhe Valon Behramit janë nga Kosova.



UEFA rrit shpërblimet, ja sa para fiton Prishtina



NYON, 6 QERSHOR - 550 milionë euro shpërblime për të gjitha skuadrat pjesëmarrëse në edicionin 2018-2019 në Evropa Ligë. Ky është buxheti i UEFA-s për kompeticionin e dytë më të rëndësishëm për klube në Evropë, një shumë ndjeshëm më e lartë se ato të akorduara në edicionet e kaluara. Çdo skuadër pjesëmarrëse në fazën e grupeve do të shpërblehet me 2.92 milionë euro. Fituesit e çdo grupi do të marrin një bonus prej një milion eurosh, ndërsa të kualifikuarat si të dytat e çdo grupi 500 mijë euro secila. Çdo fitore në fazën e grupeve vlen 570 mijë euro, ndërsa barazimi 190 mijë euro. Risia e këtij edicioni lidhet me shumën prej 84 milionë eurosh në total që do t'u shpërndalet skuadrave të mëdha me probleme financiare, në bazë të paraqitjeve në 10 vjetët e fundit. Vlera një e koeficientit është 71 430 euro, pra skuadra më e dobët në ranglistë do ta marrë këtë shumë. Kjo do të thotë se skuadra me koeficientin më të lartë, e para nga 48 skuadrat pjesëmarrëse në fazën e grupeve, do të përfitojë 3.42 milionë euro.

Por sa do të përfitojnë ekipet shqiptare?

Prishtina e Vala Superligës, që e nis nga turi paraeliminatar,

vetëm nga pjesëmarrja përfiton 220 mijë euro dhe nëse bën mrekullinë dhe kualifikohet deri në fazën e "play-off"-it, do të përfitonte në total 1.3 milionë euro. Klubet shqiptare, që e nisin në turin e parë kualifikues, deri në "play-off" do të arkëtonin 1 milion e 80 mijë euro. Prishtina, nëse bën të paimagjinueshmen dhe kalon në fazën e grupeve, do të përfitonte në total 3.92 milionë euro (pa marrë në konsideratë shpërblimet për rezultatet pozitive të mundshme në fazën e grupeve). Ndërsa për ekipet e superiores kualifikimi në fazën

e grupeve do të vrente 3.7 milionë euro. Për ta kuptuar ndryshimin mund të shërbejë kualifikimi i Skënderbeut në fazën e grupeve të Evropa Ligës në vitin 2017, i dyti në histori për klubin juglindor. Vitin e kaluar korçarët përfituan rreth 650 mijë euro nga kalimi i tureve kualifikues, shifër që në edicionin e ri do të rritej në vlerën 780 mijë euro. Ndërsa për pjesëmarrjen në fazën e grupeve, gjatë edicionit që lamë pas Skënderbeu përfitoi 2,6 milionë euro, shifër që tashmë do të rritet në vlerën e 2 milionë e 920 mijë euro.

TURET KUALIFIKUESE

Turi paraeliminatar	220.000 euro
Turi i parë kualifikues	240.000 euro
Turi i dytë kualifikues	260.000 euro
Turi i tretë kualifikues	280.000 euro
Faza play-off	300.000 euro

(Skuadrat që e kalojnë edhe fazën "play-off" nuk e përfitojnë shumën 300 000 euro, pasi marrin shpërblim për pjesëmarrjen në fazën e grupeve, 2.92 milionë euro)

FAZA E GRUPEVE DERI NË FINALE

Pjesëmarrja në grupe	2.92 milionë euro
Kualifikimi në fazën e 1/32	1 milion e para dhe 500.000 euro e dyta e grupit
Kualifikimi në fazën e 1/16	1.1 milionë euro
Kualifikimi në çerekfinale	1.5 milionë euro
Kualifikimi në gjysmëfinale	2.4 milionë euro
Kualifikimi në finale	4.5 milionë euro
Fituesi i Evropa Ligë	4 milionë euro

SHKURT

Lorenzo i bashkohet Hondas

Muajt e verës janë periudha ideale për të finalizuar goditje të bujshme në tregun futbollistik evropian, por starti i këtij qershori rezervoi edhe një manovër të bukur në një kategori që verën nuk e njeh si periudhë ndryshimi. Jorge Lorenzo e ka kthyer në zyrtarë "flirtin" e tij me skuadrën e Hondës, duke iu bashkuar ekipit japonez për sezonin e ardhshëm. Marrëveshja në fjalë u paralajmërua në fundin e garës në Mugello, aty ku ishte pikërisht Lorenzo që fitoi Çmimin e Madh të Italisë. Numri 99 nuk priti të mbaronte festa, për t'i shfaqur pakënaqësitë e tij me Ducatin, fajtor që nuk i kishte besuar në çastet e vështira. Kështu, Lorenzo vendosi t'i zgjedhë japonezët. Honda nga ana e saj nuk mund ta shpërdoronte mundësinë për të krijuar një skuadër ëndrrash, një "Dream Team" i kompletuar nga Marc Marquez për vitin 2019. Firma e mbuluar nga milionat i garanton Lorenzos një pagë të majme për dy vjet. Spanjoli merr kështu vendin e Daniel Pedrosës, që mbyll raportin e gjatë prej 18 vjetësh me skuadrën japoneze.

Ter Stegen i zhgënjyer, shkak rikthimi i Neuerit

Duket se në kampin gjerman problemet s'kanë të mbaruar. Joachim Low, pasi la jashtë Sanen, tani duhet të përballet me rivalitetin e portierëve. Ter Stegen ka luajtur pothuajse të gjitha eliminatorët, por rikthimi i Neuerit mund të bëjë që ai ta humbasë vendin në formacion. "Kam luajtur gjithë sezonin dhe kam pasur gjithmonë një nivel të lartë, kjo është një situatë zhgënjyese", ka thënë Ter Stegen. Megjithatë, ai e pranon vendimin e trajnerit dhe shprehet se do të përpiqet të jetë një ndihmë e mirë për Neuerin. Ky i fundit vjen nga një dëmtim i gjatë dhe duket se do të ruajë ai trekëndorin e gjermanëve në Botëror.

Barça transferon Griezmannin ose Salahin

Nëse Barcelona dështon ta transferojë sulmuesin e Atletico Madridit, Antoine Griezmann, atëherë alternativa e dytë është Mohamed Salah. Lajmi është bërë i ditur të mërkurën nga "AS", kurse sulmuesi egjiptian ka shkëlqyer në fanellën e Liverpoolit. Salah mund të shitet nga skuadra angleze, por vetëm për një shifër mbi 100 milionë euro.

Asnjë femër e përfshirë në renditjen e 100 atletëve më të paguar

Asnjë femër e vetme nuk është përfshirë në renditjen e 100 sportistëve më të paguar. Kjo është hera e parë që ndodh që kur "Forbes" ka filluar ta bëjë listën tetë vjet më parë. Boksieri në pension Floyd Mayweather është renditur në vend të parë për të katërtën herë në shtatë vjet pasi fitoi 275 milionë \$ në ndeshjen ndaj McGregor gushtin e kaluar, i cili është renditur në vend të katër me \$99m. Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo ndodhen në vend të dytë dhe të tretë me \$111m dhe \$108m. Gjithsesi, ajo që bie në sy më shumë është mungesa e një femre në renditje. Gjithmonë ka pasur të paktën një femër, madje në disa vjet edhe tri. Por këtë vit nuk ka asnjë, diçka shqetësuese dhe që duhet të ndryshojë. Serena Williams ka qenë atletja e vetme që u rendit mes 100 më të pasurve vitin e kaluar por, për shkak se lindi fëmijën e parë, ajo nuk ka qenë në gjendje të konkurronte. Lista, e cila përfshin të gjitha rogat dhe bonuset mes 1 qershorit 2017 dhe 1 qershorit 2018, dominohet nga sportistët amerikanë me 40 basketbollistë, 18 lojtarë të futbollit amerikan dhe 14 lojtarë bejsbolli.

Viera, trajner i Nices?

Skuadra franceze Nice e ka gjetur tashmë zëvendësuesin e trajnerit Lucien Favre, që u largua për ta marrë drejtimin e Borussia Dortmundit. Zëvendësuesi do të jetë pikërisht ish-mesfushori i Juventusit dhe Interit, Patrick Vieira, ai që do të ulet në stolin e Nices, gjatë sezonit të ardhshëm. Vieira aktualisht është trajner i New York Cityt në MLS-në amerikane dhe këtë fundjavë do ta drejtojë skuadrën në ndeshjen e fundit, ndërsa vetëm më pas do të bëhet edhe zyrtarizimi i tij si trajner i Nices.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna Dragash- Opština Dragash

Në bazë të nenit 11 dhe 18 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 22.4 të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 4.2 kërkeses së Drejtorit dhe aprovimit nga Kryetari të Komunes-Dragashë nr.03.111/01-12441 Sherbimi I Personelit shpallë:

KONKURS i brendëshëm

Titulli i vendit të punës; Udheqës i Sektorit të Pylltaris

Njësia: Njësia e Pylltaris

Niveli i pages; Koeficienti: 8

Orari i punës: Me orar të plotë (40 orë në javë)

I raporton: Drejtorit për Bujqësi Pylltari Zhvillim Rural dhe Turizem

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objekt. si dhe harton planin e punës për sektorin;
- Menaxhon stafin e sektorit, dhe në bashkëpunim me Drejt.,organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve cilësore;
- Në mënyrë periodike analizon gjendjen e pyeve, për të cilën përgatitë raport me shkrim, dhe të njëjtin e paraqet të mbikëqyrësi;
- Bën planifikimin për pyllëzimin e hapsirave të pa pyllëzuara, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të gjendjes së pyeve në komunë;
- Bashkëpunon në mënyrë të rregullt me policinë e Kosoves, me qëllim të mbrojtjes së pyeve nga prerja ilegale në territorin e komunës;
- Menaxhon projektet - kontratat që lidh komuna me operatorët ekonomik për prerjen e sipërfaqeve pyjore në mënyrë të kontrolluar, si për djegje aashtu edhe për industri;
- Bashkëpunon me Drejtorin për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në K.Dragash dhe me Ministrinë e Bujqësis Pylltaris dhe Zhvillimit rural për përmirsimin e gjendjes në lidhje me ruajtjen e pyeve dhe pyllëzimin e hapsirave të pa pyllëzuara në territorin e komunës tonë;
- Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma universitare (drejtimet fak. pylltaris në munges edhe fak. bujqësi), minimum 4 vite përvojë pune profesionale
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathtësi në udhëh. dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet);

Afati i konkursit: Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të mirren në shqyrtim. Aplikacionet mund të mirren në Zyren e Personelit nr.9 dhe dorëzohen Zyren e Pranimi

Sherbimi i Personelit



K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A. me seli në Prizren

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të punës Nr.03/L-212, Kompania Rajonale e Ujësllësit "Hidroregjioni Jugor" SH.A. Prizren, me datë 07.06.2018 shpall:

KONKURS

Pozita e punës: Vozitës i mjeteve të punës (M, L, T), 1 (një) në Njësinë Punuese në Prizren

Kompania: Kompania Rajonale e Ujësllësit "Hidroregjioni Jugor" SH.A. në Prizren

Paga: Koeficienti sipas Rregullores së Kompanisë.

Kushtet për punësim (edukimi i kërkuar)

- Përgaditja shkollore :Shkolla e mesme – kualifikim adekuat
- Përvoja e punës: Së paku gjashtë muaj

Kushtet e veçanta: Obliguese patentë shoferi me Kategoritë (M,L,T).

Detvat dhe përgjegjësitë:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës
- Kryen punët transportuese me këto automjete si dhe bartjen e punëtorëve duke ju përmbajtur Ligjit mbi sigurinë në komunikacion
- Vozitë dhe kryen veprime të punës me makina të rënda me të cilat ngarkohet ose urdhërohet nga shefi
- Kujdeset për gjendjen teknike të makinave me të cilën manipulon dhe lajmëron me kohe defektet të cilat i vëren ose heton në automjete
- Kryen vetëm punët për të cilat urdhërohet nga shefi
- Në kuadër të aftësive të veçta profesionale bënë intervenime të imta dhe riparim të imët të automjetit.
- Kryen kontrollimin e përditshëm të automjetit para daljes në komunikacion bënë evitimin e prishjeve të imta që kanë të bëjnë me vozitjen e automjetit.
- Pastron e lubrifikon automjetin, kontrollon vajin lëndën e ftohjes në motor dhe agregatet tjerë të automjetit, bënë kontrollimin dhe mirëmbajtjen e akumulatorëve, ndërrimin e filtrave si dhe të gjitha punët që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e automjetit
- Punën e makinës e arsyeton në bazë të urdhërave të punës,
- Kujdeset për regjistrimin me kohë të shpenzimeve të karburanteve dhe vajrave në listën e evidencës sipas orëve të punës së makinës
- Është përgjegjës për servisimin dhe mirëmbajtjen e rregullt të makinave
- Kryen edhe punë të tjera në bazë të urdhrit të Shefit të autoparkut.
- Për punën që e kryen përgjigjet Shefit të autoparkut.

Procedura e aplikimit:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- Biografim (CV) e detajuar,
- Letërnjoftim-kopje,
- Letërmotivimi,
- Diplomën e Shkollës mesme (Obligative diploma e noterizuar),
- Dëshmi mbi përvojën e sukseshme paraprake,
- Dëshmi që nuk është nën hetime

Aplikacionet mund të tërhiqen në zyrën të KRU "Hidroregjioni jugor" SH.A., me adresë "Rr. Wesley Clark" në Prizren.

Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen në zyrë të shërbimit për punë juridike dhe të përgjithshme të mbyllura në pako. Dokumentet nuk kthehen.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit respektivisht deri me datën 21.06.2018 në ora 16:00.

K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A. – Prizren



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna Dragash- Opština Dragash

Shodno članovima 11 i 18 Zakona br. 03 / L-149 o državnoj službi Republike Kosovo, član 22.4 Uredbe br. 02/2010 o postupcima zapošljavanja u državnoj službi Kosova i članu 4.2 zahteva direktora i odobrenja od strane gradonačelnika Dragasha, br.03.111 / 01-12441 kadrovska Služba objavljuje:

KONKURS interni

Naziv radnog mesta: šef sektora šumarstva

Jedinica: jedinica šumarstva

Nivo plata: Koeficijent: 8

Radno vreme: Puno radno vreme (40 sati nedeljno)

Izveštava: direktoru poljoprivrede, šumarstva, ruralnog razvoja i turizma

Dužnosti i odgovornosti:

- Upravljanje ukupnim radom sektora i pomoć direktoru u postavljanju ciljeva i izradu plana rada za ispunjavanje ovih ciljeva, kao i izradu plana rada za sektor;
- Menadžiranje osoblja ovog sektora, u saradnji sa Direkcijom, organizuje rad dodeljivanjem obaveza podređenima, pruža smernice i nadgleda rad osoblja za pružanje kvalitetnih proizvoda i usluga;
- periodično analizira stanje suma za koje priprema pismeni izveštaj i dostavlja supervizoru;
- Planiranje pošumljavanja neposumljenih područja u cilju kontinuiranog poboljšanja stanja šuma u opštini;
- redovno saraduje sa kosovskom policijom, kako bi se zaštitili šume od nezakonitog sečenja na teritoriji opštine;
- Upravlja Projektima - ugovorima koji povezuju opštinu sa ekonomskim operaterima za sečenje šumskih površina na kontrolisan način, kako za sagorevanje, tako i za industriju;
- saraduje sa direktorom za poljoprivredu, šumarstvo i ruralni razvoj u O.Dragash i sa Ministarstvom poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja radi poboljšanja stanja očuvanja šuma i posumljavanje neposumljenih površina na teritoriji naše opštine;
- Redovno vrsi ocenjivanje osoblja pod njegovim nadzorom i podržava njihov razvoj kroz obuku kako bi se osiguralo obavljanje njihovih dužnosti na nivou sa potrebnim standardima

Potrebne kvalifikacije i veštine:

- Univerzitetska diploma (fakultet šumarstvo, u nedostatak fakulteta poljoprivrede), najmanje 4 godine profesionalnog iskustva
 - Komunikativne, pregovarajuće i ubedljive veštine u menadžmentu;
 - Relevantnost u postavljanju ciljeva, planiranju rada i analizi;
 - Liderstvo u vođstvu. i organizaciju tima, sposobnost upravljanja timom ili radnom grupom;
 - softver za računarske aplikacije (Vord, Ekcel, Pover Point, Internet);
- Konkursni rok:** Konkurs je otvoreno 8 dana od dana objavljivanja. Nepotpuna i zaostale aplikacije neće se razmatrati. Aplikacije se uzimaju u Kancelariji za osoblje broj 9 i podnose se Kancelariji za prijem

Kadrovska služba



K.R.U "Hidroregjioni Jugor" SH.A. me seli në Prizren

